



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2699/1 Prot

Tiranë më 06.10.2023

URDHËR

Nr. 107, Datë 06.10.2023

**“PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR ANALIZËN DHE RAPORTIMIN E
INFORMACIONIT STATISTIKOR LIDHUR ME ANKESAT/ÇËSHTJET DREJTUAR
ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në zbatim të, germës c, pika 1 e nenit 204 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Urdhrit nr 2710/1 Prot, Datë 02.10.2023 “Për miratimin e formularit të ankesës, të ripunuar dhe udhëzimit për plotësimin e tij” si dhe Urdhrit nr. 2708/1 Prot, Datë 05.10.2023 “Për miratimin e formularëve statistikorë dhe Metodologjinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet kryesisht drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë për analizën dhe raportimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohen Drejtoria e Analizës dhe Standardeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

**METODOLOGJIA E
ANALIZËS
DHE
RAPORTIMIT TË
INFORMACIONIT
STATISTIKOR**

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
www.ild.al

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I	2
INFORMACION I PËRGJITHSHËM	2
1. Objekti i metodologjisë.....	2
2. Qëllimi i metodologjisë.....	2
3. Baza ligjore	2
PJESA II	2
STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE AFATET	2
2.1 Strukturat përgjegjëse	2
2.2 Analiza e informacionit.....	2
2.3 Afatet e raportimit	3
2.4 Publikimi i informacionit statistikor	3
PJESA III	4
ANEKSE	4
3.1 ANEKSI NR. 1 - TREGUESIT E RAPORTEVE STATISTIKORE	4
3.1.1 INFORMACIONI JAVOR.....	4
3.1.2 BULETINI MUJOR	4
3.1.3 BULETINI 3 MUJOR	5
3.1.4 VJETARI STATISTIKOR	6
3.1.5 BULETINI VJETOR I VENDIMEVE TË ZYRËS SË ILD-Së.....	7
3.2 ANEKSI NR. 2 - KALENDARI I PUBLIKIMIT TË RAPORTEVE STATISTIKORE.....	7

METODOLOGJIA E ANALIZËS DHE RAPORTIMIT TË INFORMACIONIT STATISTIKOR LIDHUR ME ANKESAT DREJTUAR ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PJESA I INFORMACION I PËRGJITHSHËM

OBJEKTI I METODOLOGJISË

Objekti i kësaj metodologjie është përcaktimi i mënyrës së analizës dhe raportimit të informacionit statistikor i siguruar nga baza e të dhënave të ankesave të subjekteve të ndryshme drejtuar ILD-së apo çështjet kryesisht, strukturat përkatëse, afatet si dhe kalendarin e raportimit të tyre.

QËLLIMI I METODOLOGJISË

Qëllimi i kësaj metodologjie është, analizimi në kohë reale dhe raportimi periodik i informacionit statistikor që lidhet me ankesat drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe të strukturave përkatëse pjesë e këtij procesi.

BAZA LIGJORE

Kjo metodologji i referohet gërmës c, pika 1 e nenit 204 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimit nr. 10/2023 të Kuvendit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

PJESA II STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE AFATET

2.1 STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e kësaj metodologjie janë:

1. Drejtoria e Analizës dhe Standardeve, si dhe strukturat e tjera përfshirë në këtë proces.

2.2 ANALIZA E INFORMACIONIT

Përpunimi dhe analiza e informacionit statistikor lidhur me ankesat e subjekteve të ndryshme drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë realizohet nëpërmjet Formularëve të përpunimit të informacionit statistikor miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Analiza e informacionit statistikor përmban të dhëna periodike lidhur me treguesit të cilët përfshijnë:

- Numrin e ankesave/çështjeve të trajtuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (të periudhës korente dhe periudhës së mëparshme (çështje të mbartuara);
- Numrin dhe llojin e vendimeve të mara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- Llojin e subjekteve ankuese (Person fizik & Person juridik);
- Institucionet ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre magjistratët dhe subjektet e tjera për për të cilët ka ankesë/çështje kryesisht;
- Informacionin lidhur me procesin hetimor dhe vendimet përkatëse;
- Numrin e magjistratëve të proceduar me masë disiplinore (gjyqtarë, prokurorë etj);
- Llojin e çështjeve të ndara në kategori (çështje civile, çështje penale dhe çështje administrative);
- Numrin e ankimeve lidhur me vendimet e mara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- Vendimet e këshillave përkatës KLGJ/KLP/KPA, gjykatat etj.

Çdo informacion tjetër që përpunohet dhe mund të gjenerohet nga të dhënat e grumbulluara.

2.3 AFATET E RAPORTIMIT

1. Informacioni statistikor i grumbulluar dhe analizuar nga drejtoria përkatëse do të përgatitet dhe raportohet sipas afateve të mëposhtme:
 - Informacioni javor;
 - Buletini mujor;
 - Buletini 3 mujor;
 - Vjetari statistikor;
 - Buletini vjetor i vendimeve të Zyrës së ILD-së.
2. Të gjitha raportimet sipas afateve kohore të përcaktuara në pikën 1, do të përgatiten në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

2.4 PUBLIKIMI I INFORMACIONIT STATISTIKOR

1. Raportet e informacionit statistikor të parashikuara në nenin 6, do të publikohen në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas këtyre afateve:
 - ✚ ditën e hënë të çdo jave (Informacioni javor);
 - ✚ brenda datës 10 të çdo muaji pasardhës/periudhës së raportimit (Buletini mujor);
 - ✚ brenda datën 15 pas çdo 3 mujori (Buletini 3 mujor);
 - ✚ brenda muajit shkurt të vitit pasardhës (Vjetari Statistikor);
 - ✚ brenda muajit janar të vitit pasardhës (Buletini Vjetor i Vendimeve të Zyrës së ILD-së).

PJESA III

ANEKSE

Bashkëlidhur kësaj metodologjie gjenden:

ANEKSI NR. 1 - TREGUESIT E RAPORTEVE STATISTIKORE

ANEKSI NR. 2 - KALENDARI I PUBLIKIMIT TË STATISTIKAVE

3.1 ANEKSI NR. 1 - TREGUESIT E RAPORTEVE STATISTIKORE

3.1.1 INFORMACIONI JAVOR

- ✚ Numri i ankesave/çështjeve të depozituara në ILD;
- ✚ Numri i ankesave të konfirmuara;
- ✚ Numrin e ankesave/çështjeve të trajtuara dhe ankesat në proces trajtimi;
- ✚ Numrin e magjistratëve të hetuar.

3.1.2 BULETINI MUJOR

✚ Ankesat

Numri i ankesave të depozituara në ILD;

Numri i çështjeve të nisura kryesisht nga ILD;

✚ Ankesat lidhur me

Vendimet për arkivim pas shyrtimit fillestar;

Vendimet për verifikim;

Vendimet për arkivim pas verifikimit.

✚ Procesi i hetimit disiplinor i ankesave

Vendimet për fillim hetimi disiplinor;

Vendimet për zgjatje të hetimit disiplinor;

Vendimet për ndryshim ose shtim të objektit të hetimit;

Vendimet për bashkim hetimi;

Vendimet për pezullim hetimi;

Vendimet për mbyllje hetimi;

Vendimet për riçelje hetimi;

Vendimet për marrëveshje të përbashkët pranimi.

✚ Kërkesat për procedim disiplinor

Kërkesat për procedim disiplinor drejtuar KLGJ-së, KLP-së;

Krahasimi i vendimeve të këshillave me kërkesat për procedim disiplinor të propozuar nga ILD;

Numri i magjistratëve dhe subjekteve të tjera të propozuar për masë disiplinore;

Numri i magjistratëve dhe subjekteve të tjera të proceduar me vendim të këshillit përkatës.

✚ Ankimet

Numri i ankimeve pas vendimit për arkivim pas shqyrtimin fillestar;

Numri i ankimeve pas vendimit për arkivim pas verifikimit;

Numri i ankimeve për mbyllje hetimi, etj,

3.1.3 BULETINI 3 MUJOR

✚ Ankesat

Numri i ankesave të depozituara në ILD (përfshirë edhe numrin e ankesave të mbartura nga periudha e mëparshme);

Numri i çështjeve të nisura kryesisht nga ILD (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

✚ Ankesat lidhur me

Vendimet për arkivim pas shqyrtimit fillestar (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për verifikim (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për arkivim pas verifikimit (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme).

✚ Procesi i hetimit disiplinor i ankesave

Vendimet për fillim hetimi disiplinor (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për zgjatje të hetimit disiplinor (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për ndryshim ose shtim të objektit të hetimit (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për pezullim hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për mbyllje hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për riçelje hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Numri i ankesave lidhur me vendimet për bashkim hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Vendimet për marrëveshje të përbashkët pranimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme).

✚ Kërkesat për procedim disiplinor

Kërkesat për procedim disiplinor drejtuar KLGJ-së, KLP-së (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Krahasimi i vendimeve të këshillave me kërkesat për procedim disiplinor të propozuar nga ILD (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme).

Numri i magjistratëve dhe subjekteve të tjera të propozuar për masë disiplinore (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Numri i magjistratëve dhe subjekteve të tjera të proceduar me vendim të këshillit përkatës (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme).

✚ Ankimet

Numri i ankimeve pas vendimit për arkivim pas shqyrtimin fillestar (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Numri i ankimeve pas vendimit për arkivim pas verifikimit (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme);

Numri i ankimeve për mbyllje hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme).

3.1.4 VJETARI STATISTIKOR

Ankesat

Numri i ankesave të depozituara në ILD gjatë vitit korrent (përfshirë edhe numrin e ankesave të mbartura nga periudha e mëparshme & krahasimi me vitin e mëparshëm);

Numri i çështjeve të nisura kryesisht nga ILD gjatë vitit korrent (përfshirë edhe numrin e ankesave të mbartura nga periudha e mëparshme & krahasimi me vitin e mëparshëm);

Ankesat lidhur me

Vendimet për arkivim pas shyrtimit fillestar gjatë vitit korrent (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për verifikim (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për arkivim pas verifikimit (krahasimi me vitin e mëparshëm).

Procesi i hetimit disiplinor i ankesave

Vendimet për fillim hetimi disiplinor (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për zgjatje të hetimit disiplinor (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për ndryshim ose shtim të objektit të hetimit (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për pezullim hetimi (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për mbyllje hetimi (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për riçelje hetimi (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për bashkim hetimi (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Vendimet për marrëveshje të përbashkët pranimi (krahasimi me vitin e mëparshëm).

Kërkesat për procedim disiplinor

Kërkesat për procedim disiplinor drejtuar KLGJ-së, KLP-së (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Krahasimi i vendimeve të këshillave me kërkesat për procedim disiplinor të propozuar nga ILD (krahasimi me vitin e mëparshëm).

Numri i magjistratëve dhe subjekteve të tjera të propozuar për masë disiplinore (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Numri i magjistratëve dhe subjekteve të tjera të proceduar me vendim të këshillit përkatës (krahasimi me vitin e mëparshëm).

Ankimet

Numri i ankimeve pas vendimit për arkivim pas shqyrtimit fillestar (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Numri i ankimeve pas vendimit për arkivim pas verifikimit (krahasimi me vitin e mëparshëm);

Numri i ankimeve për mbyllje hetimi (krahasimi me vitin e mëparshëm) etj.

Shënim: Informacioni statistikor periodik duhet të jetë i analizuar dhe paraqitja e tyre duhet të jetë në formë tabelare, grafike etj.

3.1.5 BULETINI VJETOR I VENDIMEVE TË ZYRËS SË ILD-SË

Buletini vjetor i vendimeve të mara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit të ankesave/çështjeve kryesisht do të përmbajë të gjitha vendimet e mara nga ILD-ja gjatë periudhës 1 vjeçare të ndara sipas llojeve (vendime për arkim pas shqyrtimit fillestar, Vendim verifikim, vendim hetimi etj).

3.2 ANEKSI NR. 2 - KALENDARI I PUBLIKIMIT TË RAPORTEVE STATISTIKORE

KATEGORIA E TË DHËNAVE	PERIODICITETI I RAPORTIMIT	DATA E PUBLIKIMIT
Numri i ankesave/çështjeve të depozituara në ILD	javor	Çdo të hënë
Numri i ankesave të konfirmuara	javor	Çdo të hënë
Numrin e ankesave/çështjeve të trajtuara dhe ankesat në proces trajtimi	javor	Çdo të hënë
Numrin e magjistratëve të hetuar	javor	Çdo të hënë
Numri i ankesave të depozituara në ILD	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Numri i çështjeve të nisura kryesisht nga ILD	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për arkim pas shqyrtimit fillestar	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Numri i ankesave ndaj vendimeve për arkim pas shqyrtimit fillestar	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për verifikim	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për arkim pas verifikimit	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Numri i ankimeve për vendimet e arkivimit pas verifikimit	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për fillim hetimi disiplinor	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për zgjatje të hetimit disiplinor	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për ndryshim ose shtim të objektit të hetimit	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për pezullim hetimi	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për mbyllje hetimi	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Numri i ankimeve vendimet për mbyllje hetimi	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendime për riçelje hetimi	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Vendimeve për bashkim hetimi	mujor	Data10 e muajit pasardhës

Vendimeve për marrëveshje të përbashkët pranimi	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Kërkesat për procedim disiplinor drejtuar KLGJ-së, KLP-së	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Krahasimi i vendimeve të këshillave me kërkesat për procedim disiplinor të propozuar nga ILD	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Numri i magjistratëve të propozuar për masë disiplinore dhe atyre të proceduar me vendim të këshillit përkatës	mujor	Data10 e muajit pasardhës
Numri i ankesave të depozituara në ILD (përfshirë edhe numrin e ankesave të mbartura nga periudha e mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Numri i çështjeve të nisura kryesisht nga ILD (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për arkivim pas shqyrtimit fillestar (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Numri i ankesave ndaj vendimeve për arkivim pas shqyrtimit fillestar (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për verifikim (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për arkivim pas verifikimit (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Numri i ankimeve për vendimet për arkivim pas verifikimit (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për fillim hetimi disiplinor (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për zgjatje të hetimit disiplinor (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës

Vendime për ndryshim ose shtim të objektit të hetimit (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për pezullim hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për mbyllje hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Numri i ankimeve për vendimet për mbyllje hetimi(krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendimet për riçelje hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për bashkim hetimi (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Vendime për marrëveshje të përbashkët pranimi	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Kërkesat për procedim disiplinor drejtuar KLGJ-së, KLP-së (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Krahasimi i vendimeve të këshillave me kërkesat për procedim disiplinor të propozuar nga ILD (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Numri i magjistratëve të propozuar për masë disiplinore dhe atyre të proceduar me vendim të këshillit përkatës (krahasimi me periudhat periodike të mëparshme)	3 mujor	Data 15 Prill / 15 Korrik /15 Tetor / 15 Janar i vitit pasardhës
Numri i ankesave të depozituara në ILD (krahasuar me numrin e ankesave të mbartura nga viti i mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Numri i çështjeve të nisura kryesisht nga ILD (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për arkivim pas shyrtimit fillestar (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës

Numri i ankesave ndaj vendimeve për arkivim pas shqyrtimit fillestar (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për verifikim (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për arkivim pas verifikimit (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Numri i ankimeve për vendimet për arkivim pas verifikimit (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për fillim hetimi disiplinor (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për zgjatje të hetimit disiplinor (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për ndryshim ose shtim të objektit të hetimit (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për pezullim hetimi (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për mbyllje hetimi (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Numri i ankimeve për vendimet për mbyllje hetimi (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për riçelje hetimi (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për bashkim hetimi (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Vendime për marrëveshje të përbashkët pranimi	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Kërkesat për procedim disiplinor drejtuar KLGJ-së, KLP-së (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Krahasimi i vendimeve të këshillave me kërkesat për procedim disiplinor të propozuar nga ILD (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Numri i magjistratëve të propozuar për masë disiplinore dhe atyre të proceduar me vendim të këshillit përkatës (krahasuar me vitin e mëparshëm)	vjetore	Brenda muajit shkurt të vitit pasardhës
Buletini Vjetor i Vendimeve të Zyrës së ILD-së.	Vjetore	Brenda muajit janar të vitit pasardhës

Shënim:

Treguesit e vjetarit statistikor mund të shtohen në periudhat në vijim.



REZULTATET E PRITSHME

- ✓ *Përpunimi dhe analizimi i informacionit statistikor;*
- ✓ *Përgatitja e raporteve statistikore periodike me bazë mujore/3 mujore/ vjetore;*
- ✓ *Përgatitja e Buletinit Vjetor të Vendimeve të Zyrës së ILD-së.*